



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 19108 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 74, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË, SHKOLLA E MESME
TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Bazuar në ligjin nr. 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", në pikën 1, 3 të nenit 24 të ligjin nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015, nr. 48/2018, datë 23.7.2018; në pikën 2 të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", Neni 23 dhe neni 24, pika 2/d).

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin **Akreditim me kusht** nr. 4, datë 17.02.2023, me nr. 22386/1 prot. datë 17.02.2023 të MFE-së me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023, për Kualifikimet profesionale të reja, sipas niveleve përkatëse në KSHK.

2. Mbështetur në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin e miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqjen e kushteve të akreditimit për kualifikimet profesionale si më poshtë:

1. "Hoteleri – Turizëm", Niveli II në KSHK, G-II-17
2. "Kuzhinë –Pastiçeri", Niveli III në KSHK, G2-III-16

3. “Bar Restorant”, Niveli III në KSHK, G1-III-18
4. “Shërbime në hotel dhe restorant”, Niveli III në KSHK, G5-III-18
5. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli IV në KSHK, G-IV-20.

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021^{*} për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknologjike, “Hysen Çela”, Durrës, do t’i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

